



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 64 prot.

Himarë, më 07.06 . 2024

**PROCESVERBAL I KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË ZBARDHUR NGA
ORGJINALI ,MBAJTUR NË MBLEDHJEN E DATËS 07.06.2024.**

Sot më datë 07.06.2024,ora 10:30 zhvillohet mbledhja e këshillit Bashkiak Himarë .
Megenëse bashkia në këtë kohë ndodhet pa kryetar për shkak të dorëheqjes së kryetares të caktuar Znj.Blerina Bala,pak minuta para mbledhjes kryesia mori vendim në rendin e ditës të shqyrtohet vetëm caktimi I një nga dy nënkryetarët e Bashkisë në mbledhje. Pikat e tjera të rendit të ditës do të shqyrtohen në mbledhjen e ardhshme. Mbledhja zhvillohet me dyer të mbyllura.

Si vendimi për ndryshimin e rendit të ditës dhe për zhvillimin e mbledhjes me dyer të mbyllura u hodh në votim me miratimin e 3/5 të këshilltarëve.

Mbledhjen e hap Kryetari Këshillit Z.Dhimitër Kapaj.

Lexon dorëheqjen e parevokueshme të Znj.Blerina Bala,ndërkohë lexon ligjin e vetëqeverisjes vendore ,nenin 61 pika 1 gërma “b”

Këshilltarja Afrovita Dhimojani: - ky ligj nuk është në funksion në lidhje me kryetarin e Bashkisë Z.Fredi Beleri.Kryetari këshillit shprehet se Z.Beleri ,nuk është paraqitur për të bërë betimin në Këshill,kështu që në detyrë ngelet Z.Goro edhe kështu kemi proceduar me zëvendës kryetar ,po lexoj ligjin e vetëqeverisjes vendore neni 60 pika 4.

Këshilltari Milto Nika:- falenderoj kryetaren Blerina Bala për drejtimin e Bashkisë në këtë pak kohë.

Këshilltarja Afrovita Dhimojani:- më vjen mirë që i referoheni ligjit kryetar ,ne si këshill kemi të drejtën të caktojnë një nga dy nënkryetarët por ne nga komisioni zgjedhor kemi kryetar Z. Beleri.

Kryetari këshillit:- ne jemi duke ju referuar ligjit.

Këshilltari Artionil Shirokaj:-Kryetari juaj do të ishte në detyrë nëse do të bënte betimin jemi në kushtet e kryetarit Z.Goro dhe vazhdojmë me zvendëskryetar.

Këshilltari Timoleo Gërdhuqi:-Ne duhet të bëjmë një zgjedhje meqenëse jeni dhe në sezonin turistik,por ligjet janë të lëvizshme ,ne kalojmë në propozome,marrim vendim por ligji e thotë mund të çohet edhe njëri nga këshilltarët në drejtimin e Bashkisë derisa të shkojë në prefekturë ky vendim të vi ligjshmëria mund të shpallen edhe zgjedhjet e reja dhe ja kështu e zgjidhim.

Kryetari këshillit:- kemi dy nënkryetarët Z.Arqilea Bollano dhe Z. Pervin Gjikuria.

Pervin Gjikuria shprehet se tërhiqet nga konkurrimi.

Hidhet në votim Z.Bollano.Kryetari këshillit ,kush është dakort për Z.Arqilea Bollano?

Kryetari këshillit:- sa vota janë pro Arqiles?

12 (dymbëdhjetë) këshilltarë pro Arqiles,ndërsa 7 (shtatë) këshilltar bojkotuan votimin.

Në mbledhje munguan dy këshilltar 1.Artan Bala ,2.Qirjako Mërkuri.

Miratohet vendimi nr.16,me 12 vota pro,7 bojkotim.

Kryetari këshillit mbyll mbledhjen.

Sekretari

Elena Memushaj